

Rëndësia e  
interuenimit të  
herëshëm për fëmijët  
me aftësi të kufizuara




# Çfarë është aftësia e kufizuar?

Fëmijët ndryshojnë për nga shpejtësia e zhvillimit të tyre dhe aftësitë e caktuara të cilat i zotërojnë. Aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me aftësi të kufizuar dhe barrierave të krijuara nga qëndrimet apo mentaliteti i shoqërisë dhe nga ambienti, e që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në bazë të barabartë me të tjerët. Anëmbanë botës, afërsisht 1 nga 10 fëmijë jetojnë me ndonjë lloj aftësi të kufizuar të moderuar apo të rëndë. Këto mund të jenë aftësi të kufizuara të të dëgjuarit, të të pamurit, të të nxënimit, fizike, të komunikimit, të sjelljes, etj. Fëmijët mund të kenë një apo më shumë aftësi të kufizuara, të cilat mund të jenë të lindura apo të fituara më vonë.

KUJDESI DHE ZHVILLIMI GJATË FËMIJËRISË SË HERSHME  
JANË TË RËNDËSISHME PËR TË GJITHË FËMIJËT PA DALLIM

Fëmijëria e hershme është moshë kur fëmijët zhvillohen më shpejtë se në cilëndo moshë tjetër, dhe është periudha kur fëmija hulumton ambientin përreth, përmes shqisave të të prekurit, të pamurit, të shijuarit, të dëgjuarit dhe të nuhaturit. Ndërkohë ngacmimi i këtyre shqisave nxit proceset dhe zhvillimin motorik, kognitiv, të gjuhës dhe komunikimit, si dhe zhvillimin socio- emocional. Shumë nga shkathtësitë jetësore themelore që do të shërbejnë për gjithë jetën, mësohen dhe zhvillohen në pesë vitet e para të jetës, prandaj është e rëndësishme që të gjithë fëmijëve t'u ofrohen eksperiencat të larmishme që stimulojnë zhvillimin e këtyre shkathtësive.

- Fizike - mbajtja e kokës lartë, zgjatja e dorës, manipulimi me objekte të mëdha e të vogla, rrotullimi, ulja, zvarritja, ecja, vrapimi, etj.
- Kognitive-njohëse - të menduarit, të mësuarit, lidhja mes shkakut dhe pasojës, zgjidhja e problemeve, etj.
- Komunikimi dhe gjuha - mimika, gjestikulacionet, të dëgjuarit, të kuptuarit, të folurit, etj.
- Socio-emocionale - loja, ndjenja e të qenit sigurtë, lumtur, përkatësia në familje e shoqëri, etj.
- Vetë-kujdesi - të ushqyerit, të veshurit, të mbathurit, përdorimi i tualetit, etj.



*Fëmijët me aftësi të kufizuara vërtetë përfitojnë nga intervenimi i hershëm - sa më parë, aq më mirë*

Hulumtimet tregojnë që ofrimi i mbështetjes herët në jetë lidhet me rezultate dhe arritshmëri më të larta për fëmijët në përgjithësi, familjet dhe komunitetet, veçanërisht kur kjo mbështetje ofrohet në ambientet më të afërta të fëmijës - në familje dhe brenda komunitetit ku jeton, në qendrat e bazuara në komunitet, në qendrat e mjekësisë familjare dhe institucionet edukativo-arsimore më të afërta. Intervenimi i hershëm nënkupton një sistem të shërbimeve profesionale të dizajnuara sipas nevojave individuale, për t'u ndihmuar fëmijëve me aftësi të kufizuara drejtpërdrejt dhe përmes ofrimit të mbështetjes për prindërit e tyre.




# Kur dhe si duhet të ofrohet intervenimi i hershëm?

Duke nxitur zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, intervenimi i hershëm i minimizon vështirësitë në të nxënë dhe përshpejton zhvillimin e fëmijës. Po ashtu, i redukton shpenzimet duke minimizuar nevojën për shërbimet arsimore të veçanta (speciale). Intervenimi i hershëm është më efektiv dhe më pak i kushtueshëm nëse ofrohet me herët në jetë, gjatë moshës 0-6 vjeç. Intervenimi i hershëm ofrohet më së miri atëherë kur ofrohet i integruar mes shërbimeve dhe programeve të ndryshme të shëndetësisë, arsimit dhe mirëqenies sociale. Një intervenim i hershëm i mirë do të jetë i fokusuar në familjen, i strukturuar mirë, dhe i bazuar në fakte të besueshme, duke marrë parasysh nevojat individuale të fëmijës dhe duke i rishikuar ato në mënyrë periodike, për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës në zhvillim.

**Përfitimi për fëmijën:** Një fillim i mbarë në jetë, rezultate më të mira në fushat e ndryshme të zhvillimit, shëndet, gjuhë dhe komunikim, kognitive dhe socio-emocionale, duke përmirësuar cilësinë e jetës dhe mundësitë për gjithëpërfshirje në arsim dhe shoqëri në të ardhmen.

**Përfitimi për familjen:** Njohuri për t'i mbështetur dhe plotësuar nevojat e fëmijëve nga fëmijëria e hershme dhe gjatë gjithë jetës.

**Përfitimi i shoqërisë:** Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse në të cilën marrin pjesë dhe respektohen të drejtat e të gjithë qytetarët pavarësisht aftësive të tyre, dhe zvogëlimi i kostos financiare përmes reduktimit të nevojës për arsim special dhe shërbime të tjera të veçanta.





**Save the  
Children**

**Save the Children**

Rr. Gazmend Zajmi, nr. 01  
10000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni: +383 (0) 38 23 26 91  
Fax: +383 (0) 38 23 26 93

Email: [scik@savethechildren.org](mailto:scik@savethechildren.org)  
<https://www.facebook.com/savethechildreninkosova>